



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 18.12.2020

Më datë 18 Dhjetor u mbajt takimi i dytë për vitin 2020 i Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat, KKN. Drejtori i përgjithshëm i Institutit të Statistikave, INSTAT, njëkohësisht edhe Kryetar i KKN, Znj. Elsa Dhuli përshëndeti anëtarët e KKN-së. Draft agjenda u diskutua dhe u miratua nga të gjithë anëtarët.

Në mbledhjen e radhës së KKN-së u diskutua:

1. Rregullorja e re e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave;

Kryetarja e KKN-së Znj. Elsa Dhuli bëri një përshkrim të shkurtër të rregullores së re të KKN-së e cila ju është dërguar anëtarëve paraprakisht për komente. Znj. Dhuli vijoi me diskutimin për secilin nen të rregullores ku ju kërkua anëtarëve që gjatë periudhës kohore deri në caktimin e mbledhjes së radhës së KKN të rishikojnë dhe të japin komentet apo sugjerimet e tyre. Rregullorja do të kalojë për miratim në mbledhjen e rradhës.

2. Nomenklatura e shteteve dhe territoreve në tregtinë e jashtme, gjeonomenklatura (GEONOM)

Znj. Alma Mara përgjegjëse në sektorin e tregtisë së jashtme pranë INSTAT, bëri një prezantim të klasifikimit GEONOM dhe klasifikimi ISO APLHA 2 i cili përdoret ndërkohë në Shqipëri. Nomenklatura (klasifikimi) e Shteteve dhe territoreve në tregtinë e jashtme e njohur ndryshe edhe si Gjeonomenklatura shërben për grumbullimin (mbledhjen) dhe shpërndarjen e statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas vendeve me të cilat kryhet tregtia e mallrave. Instituti i Statistikave, INSTAT përdor klasifikimin ISO alpha 2, një klasifikimi ndërkombëtar për kodet e vendeve dhe kodet për nënndarjet e tyre. Kodifikimi alfabetik i shteteve dhe territoreve bazohet në versionin aktual të Klasifikimit Standardi ISO alpha 2 (ISO 3166).

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



3. Diskutime mbi nomenklaturën ISCED

Në vijim fjalën e mori përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë (MASR) Z. Novruz Ahmeti.

Z. Ahmeti sqaroi se si përfaqësues i MASR në këtë komision është njohur me kërkesat e INSTAT. Edhe pse i ri në pozicionin e punës menjëherë ka komunikuar me dy nga drejtoritë më të rëndësishme të MASR të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen në fjalë.

Më tej është njoftuar se do të bëhet me dije Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me ngritjen e një grupi ekspertësh mbi kodifikimin e programeve të studimit të lartë. Z. Ahmeti u tregua optimist për kryerjen sa më shpejt e në kohë të këtij procesi.

Përfaqësuesit e MASR dhe INSTAT do të analizojnë të gjitha komentet e që Institucionet e Arsimit të Lartë kanë shprehur, e ti reflektojnë në klasifikimin ISCED.

4. Diskutime të tjera

Znj. Dhuli bëri me dije se INSTAT ka hartuar planin e aktiviteteve të KKN për vitin 2021. Rregullorja dhe plani i aktiviteteve do finalizohet duke reflektuar sugjerimet dhe komentet e anëtarëve të KKN, dhe do të miratohen në takimin e parë të KKN vitin e ardhshëm..

Anëtarët dakortësuan të gjithë në lidhje me çështjet e propozuara.

Përgatiti:
Sekretariati i KKN